

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Vila 1909 Vuno“ shpk

Në Tirane, sot më datë 11.02.2022, unë Ameraldo Muça, i biri i Hekuranit, lindur në datë 15.04.1989, në Bulqizë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga SHOTË GALICA, Ndërtesa Nr. 3, SH/K 1, i pajisur me dokument identifikimi, me numër personal I90415010T dhe unë Lorenc Lusha, i biri i Luanit, lindur në datë 03.0.1985, në Tepelenë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Medar Shtylla, Ndërtesa Nr. 236, SH/K 1, Apartamenti Nr. 3, i pajisur me dokument identifikimi, me numër personal I50603033W, me cilësinë e “Ortakëve themelues“ deklarojmë se me vullnet të lirë, të plotë e të sigurtë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “Vila 1909 Vuno” shpk .

KREUI

Neni 1
Krijimi

Shoqëria “Vila 1909 Vuno” shpk, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

1. Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
2. Shoqëria “Vila 1909 Vuno” shpk është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Ameraldo Muça dhe Lorenc Lusha, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën Zona Kadastrale 3844, Nr Pasurisë 1/186 ,Vuno, Himarë.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Kjo shoqëri do të ushtrojë aktivitetin e saj në:

Ameraldo



- ❖ Në fushën e turizmit, hapja dhe menaxhimi i hoteleve, godinave dhe ambienteve në të cilat ushtrohet aktivitetet hotelier.
- ❖ Hapja dhe menaxhimi i sallave të konferencave në kuadër të aktivitetit hotelier.
- ❖ Hapja, menaxhimi dhe funksionimi i qendrave të rekreacionit, me ose pa profil të dermo-estetikës, trajtimit të lëkurës dhe trupit, për masazhe, spa, mirëmbajtje trupore, fitness, dhe pishina.
- ❖ Në fushën e qiradhënies së zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme që i përkasin hotelit.
- ❖ Kryerja e tregtimit, prodhimit dhe përpunimit të mallrave, që kanë të bëjnë me aktivitetin e hotelerisë.
- ❖ Hapja e menaxhimi i bareve dhe restoranteve brenda strukturës hoteliere si edhe ushtrimi i aktivitetit në fushën e këmbimit valutor.

Si edhe çdo veprimtari tjetër që i shërben rritjes dhe zhvillimit të kësaj shoqërie në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhe kohore: *Pa afat*, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga "ortakët " e shoqërisë:
2. Ameraldo Muça, zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 50 000 Lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Lorenc Lusha, zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 50 000 Lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
4. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).
5. Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

Ameraldo

Lorenc

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme.

KREU III *ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE*

Neni 8 Asambleja e Përgjithshme

1. Ortakët janë organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë dhe përbën Asamblenë e shoqërisë.
2. Asambleja merr vendim, por pa u kufizuar për çështje si:
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve;
 - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesit dhe/ose të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera administrative;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - g) çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
3. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
 - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
3. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Administrimi

Anaraldo



Administrator i shoqërisë është z. Ameraldo Muça, identifikuar me dokument me numër personal I90415010T, emëruar në këtë detyrë për një afat 5(pesë) vjeçar me të drejtë ripërtëritje. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakëve të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat e Administratorit

1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqeset këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin "Për regjistrimin e biznesit" dhe ligje të tjera në fuqi;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

2. Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Asamblesë të ortakëve edhe në rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

3. Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.

4. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

5. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11



Prishja e shoqërisë mund të bëhet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 12

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplarë në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare "X" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij orgjinale.

ORTAKËT

Ameraldo Muça

Ameraldo Muça
Ameraldo

Lorenc Lusha

Lorenc Lusha
Lusha